

KOHA E DEVOCIONIT

"Përgatitja më e mirë për një ditë është që të jemi të sigurt, që ne kemi parë fytyrën e Zotit përpara se të shohim fytyrën e njeriut".

I. Ç'është KOHA E DEVOCIONIT?

A. Një kohë e veçantë çdo ditë për:

- shoqëri-adhurim-komunikim me Perëndinë nëpërmjet fjalëve e lutjeve
- Zotin që t'u flasë zemrave tona dhe për ne që t'i flasim Atij
- të marrim udhëheqjen prej tij. Shembuj nga Zoti ynë: Marku 1:35; Luka 5:16; Mateu 14:23.

II. Pse është KOHA E DEVOCIONIT e nevojshme?

A. Ne i tregojmë Krishtit se e duam. **OBJEKTI I DASHURISË SONË ESHTË ZAKONISHT OBJEKTI ME TË CILIN NE HARXHOJMË KOHËN TONË.** Provë e dashurisë sonë është dëshira për të qenë me atë person. Psalm 42:1,2; Psalm 27:4

B. Ati kërkon adhurues - Gjoni 4:23; Luka 10:38-42

C. Mirëqenia jonë shpirtërore - Efesianëve 6:10-18; Mateu 4:4-10

"NJË MARRËDHËNIE ME PERËNDINË E LËNË PAS DORE LEJON DOBËSITË E TUA TË TË KONTROLLOJNË NDËRSA FORCAT E TUA TË ZVOGËLOHEN."

III. Kush janë disa nga përfitimet?

- 1 Pjetër 2:2 -Rritje
- Psalmi 119:9-11 -Fitore mbi mëkatin
- Psalmi 119:105 -Udhëheqje
- Psalmi 119:24; Isaia 9:6 -Këshilla
- Rom. 10:17 -Besim që rritet
- Jeremia 15:16 -Gëzim
- Jozueu 1:8 -Sukses në jetën e krishterë
- Isaia 50:4 -Aftësi për të mësuar të tjerët.
- 2 Tim. 3:16,17 -I pajisur plotësisht për çdo vepër të mirë

IV. Kush janë elementet themelore për një kohë devocioni efektive?

KOHE - Ndërtimi i çdo lloj marrëdhënie kërkon kohë (rritja kërkon kohë). N.q.s. do të njohësh Perëndinë (jo vetëm të njohësh rreth Tij) do të jetë e nevojshme të kalosh kohë me Të. Lëri gjërat e tjera të shkojnë, por mos e lër pas dore Atë. Lër mënjatë një kohë për Të çdo ditë.

QËNDRIMI - Në çdo lloj marrëdhënie qëndrimi ynë është i rëndësishëm sepse do të vendosë arritjen tonë në një rrethanë të dhënë. Një qëndrim i shëndoshë do të sjellë rritje. Një shpirt që dëshiron të mësojë dhe di të presë janë qëndrime të shëndosha. Ne duhet të presim këtë si një kohë gjatë së cilës ti merr nga Zoti dhe i jep Atij.

KOMUNIKIMI - Për një marrëdhënie që do të zhvillohet duhet të ketë komunikim (të flasësh & të dëgjosh). Kanali duhet të jetë i hapur. Nuk duhet të pengojmë komunikimin. Duhet të jemi transparentë përpara Perëndisë.

QËNDRUESHMËRI - Bindja se kjo kohë është themelore për rritjen shpirtërore dhe e padetyrueshme do të na bëjë të mundur ta takojmë Zotin pavarësisht nga situatat. Qëndrueshmëria jonë do të na zbulojë sa të thella në Zotin janë rrënjët tona.

QËLLIMI - Qëllimi mbi të gjitha duhet të jetë i qartë. Një kohë devocioni është koha për të njohur Zotin në një mënyrë domethënëse për t'u bërë një dishepull-shërbëtor i Zotit Jezus. Nuk është një kohë vetëm për të lexuar Biblën, por është po aq e rëndësishme sa edhe kjo. Nuk është një kohë për studim, por një kohë për një lexim të mendueshëm dhe nxjerrje zbatimesh për jetët tona. Është e rëndësishme gjithashtu të kesh

qëllime të tjera në mënyrë që të takosh qëllimin kryesor. Për shembull, n.q.s. sheh se ke dobësi në adhurimin e Perëndisë do të ishte e këshillueshme të kalonit kohën tuaj të devocionit tek Psalmet dhe ta lejosh Zotin të të mësojë përse duhet një adhurim.

V. SUGJERIME PRAKTIKE SE SI TE NDERTOSH NJE KOHE DEVOCIONI

A. Të jesh i ngopur me gjumë - Psalmi 127:2; Fja. 6:9-11; Fja. 26:14

B. Gjej një vend ku të mos ndërpriten momentet e tua të shenjta me Zotin (vend që do të bëhet si një shenjtorë e vogël. Bëje këtë kohë përpara se të biesh në shtrat).

C. LUTU - LEXO - GJEJ ZBATIM - LUTU (mos merr më shumë se 12 vargje ose një kapitull kur nuk është shumë i gjatë)

1. LUTU - Kërko Perëndisë të hapë zemrën tënde dhe të të pastrojë mendjen në mënyrë që të mendosh mendimet e Perëndisë. Rrëfe ndonjë mëkat që njeh. Psalmi 119:18; Psalmi 139:23-24

2. LEXO - Me ngadalë. Kush është mesazhi kryesor i fragmentit?

3. ZBATIM - ç'ndikim ka mbi mua personalisht? Bëji vetes këto pyetje. Është ky :

SHEMBULL për ta ndjekur?

URDHER për t'iu bindur?

GABIM për t'iu shmangur?

MEKAT për ta braktisur?

PREMTIM për ta pohuar?

MENDIM I RI për Zotin?

SHENIMI I KOHES SE DEVOCIONIT. Në fillim titullo fragmentin tënd, pastaj një koment për atë që ke zbuluar dhe ç'përshtypje të ka bërë. Pastaj, shkruaj zbatimin e tekstit për jetën tënde.

JI KONKRET me zbatimet!

FORMATI I SHENIMIT TE KOHES SE DEVOCIONIT:

DATA _____ FRAGMENTI _____
TITULLI _____

KOMENTI: (Për çfarë bën fjalë fragmenti?)

ZBATIMI: (çfarë duhet të bëj?)

4. LUTU - Adhuro Perëndinë në lutje. Pastaj ofroji ditën Perëndisë dhe tregoji kërkesat që ke.

A - Adhurim - nderim për atë që është Perëndia, jo për atë që ka bërë për ne.

RR - Rrëfimi - Rrëfe ndonjë mëkat që Perëndia të ka bërë të njohur gjatë kohës me Të.

F - Falënderim - E njëjtë me adhurimin. Falënderojmë për bekimet që na jep dhe e Falënderojmë.

K - Kërkesa - Ndërhyrje kur ke një shqetësim për një person. Lutu me emër. Gjithashtu lutu për nevojat e përditshme. Kërkoji forcë, drejtim dhe sigurime materiale. (Mbah një listë lutjesh)

5. MBANI MEND - Parime pa metoda për t'u zbatuar janë veçse idealizma. Shumë njerëz harxhojnë kohën duke lexuar Biblën dhe duke u lutur përditë pa zhvilluar një lidhje me Zotin sepse Fjala nuk është zbatuar asnjëherë konkretisht në jetët e tyre.